

VENDIM
Nr.32, datë 26.5.2006

**PËR MIRATIMIN E ÇMIMEVE TË SHITJES ME PAKICË TË ENERGJISË
ELEKTRIKE NGA KESH SHA PËR KONSUMATORËT FUNDORË PËR PERIU DHËN
1 KORRIK 2006 – 31 DHJETOR 2006**

Në mbështetje të neneve 8, pika 2 germa b), 9, 26, pika 1, 27 dhe 28, të ligjit 9072, datë 22.05.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, vendimeve të Bordit të Komisionerëve nr.28, datë 24.06.2005, nr.29, datë 24.06.2005, nr.30, datë 24.06.2005, përkatësisht “Metodologjitë e llogaritjes së tarifave për kompaninë publike të gjenerimit, të llogaritjes së tarifave të shpërndarjes së energjisë elektrike dhe të llogaritjes së tarifave të shitjes të klientët tariforë”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike (ERE), në mbledhjen e tij të datës 26.05.2006, pasi shqyrtoi dhe analizoi kërkesën e paraqitur nga shoqëria KESH sh.a. për miratimin e çmimeve të shitjes me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët fundorë për periudhën 1 korrik 2006-31 dhjetor 2006,

VENDOSI:

1. Çmimet e shitjes me pakicë të energjisë elektrike nga KESH sh.a. për konsumatorët fundorë për periudhën 1 korrik 2006-31 dhjetor 2006, të jenë sipas tabelës bashkëlidhur vendimit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Pjetër Dema

**ÇMIMET E SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE TË APROVUARA NGA ERE
PËR PERIU DHËN 1 KORRIK-31 DHJETOR 2006**

KATEGORITË E KONSUMATORËVE	ÇMIMI (lekë/kWh)
Konsumatorë të furnizuar në TL (400/220/110 kV) me asete të zotëruara nga vetë konsumatori	4.50
Konsumatorë të furnizuar në TM (35,20,10,6 kV)	
Buxhetorë	9.40
Ujësjiellës buxhetorë	7.00
Ujësjiellës jobuxhetorë	7.00
Ujësjiellës privatë	7.00
Industri private	7.00
Industri jobuxhetore	7.00
Jobuxhetorë të tjerë matur në TM	7.00
Jobuxhetorë të tjerë matur në TU	7.00
Privatë të tjerë matur në TM	7.00
Privatë të tjerë matur në TU	7.00
Prodhues mielli dhe buke	7.00
Stacione pompimi	7.00
Institucione fetare	7.00
Media	7.00

Konsumatorë të furnizuar në TU (0.4 kV)	
Buxhetorë	10.00
Ujësjiellës buxhetorë	7.50
Ujësjiellës jobuxhetorë	7.50
Ujësjiellës privatë	7.50
Industri jobuxhetore	8.00
Jobuxhetorë të tjerë	8.00
Privatë	8.00
Prodhues mielli dhe buke	7.50
Stacione pompimi	7.50
Institucione fetare	8.00
Media	8.00
Konsumatorë familjarë	7.00
Tarifa mesatare për 6-mujorin e dytë të vitit 2006	7.21 lekë/kWh

Shënim. Energjia e përdorur për ambientet e përbashkëta (ndriçim shkalle, pompë, ashensor, etj.) do të faturohet me 7 lekë/kWh.